

Klasa përgatitore (VKL)

Çfarë është një klasë përgatitore?

Fëmijët që vijnë në Baden-Württemberg nga një vend tjetër dhe nuk flasin gjermanisht, zakonisht ndjekin një klasë përgatitore (shkurtesa: VKL). Quhet gjithashtu edhe klasa e mirëseardhjes. Aty mësojnë gjermanisht, në mënyrë që së shpejti të ndjekin mësimet në klasat e rregullta. Ka gjithashtu edhe përgatitje për të rinjtë, të cilët duan të fillojnë me formimin profesional. Kjo quhet VABO (Përgatitje për punë dhe profesion). Edhe atje fokusi është në përvetësimin e aftësive të gjuhës gjermane.

Në disa shkolla, VKL nuk zhvillohet paraprakisht, por paralelisht me mësimet normale. Çdo javë fëmijët, gjegjësisht të rinjtë, takohen në grupe të vogla për disa orë. Pjesën tjetër të kohës ata ndjekin mësimet e rregullta, kryesisht në lëndë të tilla si matematika, edukimi fizik ose arti.

Cila është përparësia e klasës përgatitore?

Në VKL, nevojat e studentëve që nuk flasin gjermanisht mund të plotësohen mirë. Përmbajtjet e mësimit mund të koordinohen më mirë se në klasat normale. Përmirësimi i gjuhës gjermane monitorohet me vëmendje. Nxënësit praktikojnë shkrimin, leximin dhe të folurit në gjermanisht.

A kanë fëmijët një disavantazh nga klasa përgatitore?

Ndjekja e VKL i ndihmon fëmijët dhe të rinjtë të mësojnë sa më shpejt gjuhën gjermane. Pa aftësitë e të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, ata do ta kishin të vështirë të ndiqnin një klasë të rregullt. Ata do të kuptonin më pak se nxënësit e tjerë.

Duke ndjekur VKL, ata mund të përqendrohen plotësisht në mësimin e gjuhës gjermane. Kjo është shumë e rëndësishme për mësimin e rregullt. Mësuesi e përcjell nga afër se kur një student mund të transferohet në klasën e rregullt. Kjo mund të arrihet vetëm pas disa muajsh. Për ta bërë më të lehtë ndryshimin, mësuesit në VKL diskutojnë gjithashtu tema që trajtohen në klasat e rregullta.